



Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	23.08.2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojcë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	5782/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.882/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- Kryetare, Arben Ahmeti dhe Eshref Shabani- anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.882/2023 të datës 26.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë [REDACTED]

[REDACTED] kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.882/2023 e datës 26.06.2023 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] i punësuar në Agjencinë e Punësimit-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve sipas Akt Emërimit me numër protokolli 02 të datës 28.12.2017, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4902/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të Agjencisë së Punësimit /Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me kategorizimin e pozitës së tij të punës në Kategorinë Profesionale 3 si dhe kundër ekzekutimit të ndalesës së shumës së caktuar të hyrave nga paga bazë për periudhën tre mujore për shkak të kategorizimit të pozitës së tij gabimisht në Profesional 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 05.07.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me Vendimin me numër të protokollit 5562/2023 të datës 07.08.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.882/2023 të datës 26.06.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse**

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimit me numër protokollit 02 të datës 28.12.2017 rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Nëpunës për Informim", në Zyrën e Punësimit në Prishtinë të Agjencisë së Punësimit, pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me koeficient të pagës gjashtë pikë pesë (6.5), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ne bazë të dëshmimeve të ofruara ka konstatuar se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë ankuesin e ka kategorizuar në Kategorinë Profesionale 2 me koeficient të pagës 5.1, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Punësimit me datën 22.03.2023 ka dërguar kërkesën në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB për korrigjimin e koeficienteve të pagave që lidhet edhe me pozitën e ankuesit ku ka kërkuar që i njëjti të kategorizohet në Profesional 3 me koeficient të pagës 4. Tutje me ekuivalentimin e pozitës së tij të punës nga Departamenti i Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë ankuesi nga muaji Shkurt 2023 pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik dhe ekuivalentimit të pagave nga sistemi i vjetër në sistemin e ri për 4 muaj konkretisht për muajin (shkurt, mars, prill dhe maj) ka pranuar të hyra sipas koeficientit të pagës 5.1 gjegjësisht sipas përgjigjjes së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit ankuesi ka pranuar gjithsejtë 435.88 Euro më shumë për shkak të kategorizimit gabimisht nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Punësimit e ka njoftuar ankuesin se do të realizohet ndalesa prej 435.88 Euro, e ndarë në tri pjesë për tre muajt në vijim, konkretisht në muajin Qershor, Korrik dhe Gusht të vitit 2023.

Ankuesi, me datë 26.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka kategorizuar ankuesin në Kategorinë Profesionale 3, ndërsa i njëjti po ashtu ka kërkuar ndryshimin nga kategoria aktuale si dhe ka kërkuar që të ndalohet ekzekutimi i ndalesës së shumës së caktuar të hyrave nga paga bazë për periudhën tre mujore për shkak të kategorizimit të pozitës së tij gabimisht në Profesional 2.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nënin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim

i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj'', dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia e Punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.


Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.882/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI



Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI




Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit 
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

